



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 703/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18/10/2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kulaifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Omega Optikal” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Marrëveshje Kuadër*”, me objekt Loti 1 “*Materiale mjekësore për ndërhyrjen e Kataraktit*”, me nr. REF-70198-05-21-2018, me fond limit për njësi 36.300 lekë (pa TVSH) dhe vlerë totale të pritshme të kontratës 37.640.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë tereza”, Tiranë.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pegasus” sh.p.k. & “Gen-Albfarma” sh.p.k.
Rr. “Siri Kodra”, Nr.149, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë tereza”, Tiranë
Rruga e Dibrës, nr.372, Tiranë

Subjekt i interesuar:

“Omega Optikal” sh.p.k.
Rruga “Hoxha Tahsim, Pallati Nr. 103, Kati 1, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga BOE ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. BOE ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së b ankimues.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.05.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “ *Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër*”, me nr. REF-70198-05-21-2018, Loti 1, me objekt “*Materiale mjekësore për ndërhyrjen e Kataraktit*”, me fond limit 37.640.000 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 06.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|----------------------------|---|
| 1. "Omega Optikal" sh.p.k. | vlera për njësi 13.400 lekë, kualifikuar; |
| | Vlera totale 14.352.000 lekë pa tvsh |
| 2. "Pegasus" sh.p.k. | |
| & "Gen-Albfarma" sh.p.k. | vlera për njësi 28.700 lekë, kualifikuar; |
| | Vlera totale 36.800.000 lekë |

II.3. Në datën 23.07.2018 operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 30.07.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Pegasus” sh.p.k. & “Gen-Albfarma” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ”Omega Optikal” sh.p.k.

Konkretisht operatori ekonomik pretendon si më poshtë vijon:

[...]

- 1. OE Omega Optikal nuk ka plotësuar kërkesat e pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit ku kërkohet që për qëllime kualifikimi OE duhet të paraqesin: “Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të jimit (2015, 2016, 2017), të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet. Mbështetur në VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004" Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar", bilanci duhet të depozitohet në organet tatimore jo më vonë se data 31 Mars e vitit pasardhës, ndërsa bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, neni 43, pika (a), bilancet duhen depozituar në QKB jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Duke iu referuar ekstraktit historik të shoqërisë Omega Optikal të datës 24.07.2018 (Aneksi 4), rezulton se Bilancet e vitit 2015 dhe 2016 të kësaj shoqërie janë të pakonfirmuara nga tatimet, ndërsa Bilanci i vitit 2017 nuk është fare i depozituar në QKB. Në këto rrethana, për shkak të mosdepozitimit të bilanceve sipas kërkesës së pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit, KVO duhej ta kishte skualifikuar këtë operator dhe të mos pranonte ofertën e tij.*
- 2. KVO e AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 56 (1) dhe 57 (1) të Ligjit Për Prokurimin Puka dhe nenit 66 (3), (5) të VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, me mënyrën se si ka vepruar me verifikimin e ofertës së OE Omega Optikal si ofertë anomalisht e ulët. Nga konsultimi i SPE vërejmë se në datë 23.07.2018, pra në të njejtën ditë kur është njoftuar kualifikimi dhe renditja e ofertave, është hedhur në sistem kërkesa e KVO të AK për sqarime nga OE Omega Optikal për ofertë të konsideruar anomalisht të ulët dhe në të njejtën ditë ky OE kthen përgjigje në sistem, përgjigje e cila është vetëm kaq: “Pershendetje. Cmimet e ofruara janë me konkureshë dhe të ulta ngaqë si operator i ri duam të jemi pjesë e tregut, dhe kjo dhe me mbështetjen e kompanive furnizuese. Omega optikal punon kryesisht me operatore privat, dhe për të kete kete tender e shikon si mundesi për hyrjen dhe në tregun e spitaleve. Omega optika mer persiper ofrimin e materialeve të kerkuare nga ju sipas specifikimeve perkatese me cmimet e oferte se paraqitur nga ana jone, shpresoj ne mirekuptimin tuaj. " Duket se kjo përgjigje ka qenë e mjaftueshme për KVO e AK për të kualifikuar këtë OE dhe për të pranuar ofertën e tij me gjithë vlerën anomalisht të ulët dhe parregullsitë dhe mosplotësimet e listuara më sipër. Mënyra e mësipërme e trajtimit të sqarimeve për ofertën anomalisht të ulët është tërësisht në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara. Së pari, sipas nenit 56 (1) të LPP, kërkesa e AK për operatorin me ofertë anomalisht të ulët duhet bërë në mënyrë shkresore dhe jo duke u hedhur në sistem, pasi kështu është shkelur neni 57 (1) i LPP.*

Së dyti, sic përcakton neni 56 (1) i LPP, AK duhet ti kërkonte këtij operatori në mënyrë të detajuar shpjegime për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e mallrave; c) origjinalitetin e mallrave të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të sigurohet furnizimi. Në fakt AK nuk e ka bërë kërkesën në këtë mënyrë sic kërkohet nga ligji. Së treti, sipas nenit 66 (5) të VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, ofertuesi të cilit i kërkohen sqarimet për ofertën anomalisht të ulët, jo vetëm duhet të përgjigjet në formë shkresore (cka nuk rezulton të ketë ndodhur), por për më tepër “ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shbesore sqarime! për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LP Asnjë argumentim konkret nuk është bërë nga ky ofertues, dhe as nuk janë paraqitur prej tij prova shkresore që të sqarojnë elementet e veçanta të ofertës së tij sic kërkohet nga ligji. Ky ofertues është mjaftuar me një paragraf të përgjithshëm të hedhur në sistem që nuk sqaron asgjë dhe cka është më e papranueshme dhe tërësisht e kundraligjshme është që ky lloj “sqarimi” në mënyrë të papërgjegjshme është konsideruar i mjaftueshëm nga AK.

3. Oferta e OE Omega Optikal është paraqitur e nënshkruar nga një person, i cili në momentin e paraqitjes së saj më datë 06.07.2018, nuk ka qenë i autorizuar ligjërisht për të përfaqësuar rregullisht këtë shoqëri në marrëdhënie me të tretët, konkretisht AK. Nga ekstrakti historik i shoqërisë Omega Optikal (Aneks 4 bashkëlidhur kësaj ankese), rezulton se mandati i Administratorit të kësaj shoqërie (Ardian Njehrrëna) ka mbaruar më datë 23.06.2018. Po sipas këtij ekstrakti historik, rezulton se më datë 18.07.2018, pra 12 ditë pas hapjes së ofertave, në QKB është dorëzuar aplikimi me nr. CN-877244-07-18 për regjistrimin e Vendimit të datës 24.06.2018(! ! !) për zgjatjen e afatit të Administratorit nga data 24.06.2018 deri më datë 23.06.2023. Nenet 12 dhe 95 të Ligjit 9901/2018 dhe neni 21 i Ligjit 9723/2007 të sipërcituara, tregojnë qartë se emërimi i Administratorit mund tu kundrejtohet palëve të treta vetëm pas regjistrimit të këtij emërimi në QKB, pra në rastin konkret vetëm pas datës 24.07.2018. Ky aplikim është regjistruar dhe publikuar në QKB në Regjistrin Tregtar më datë 24.07.2018, pra është e qartë se në datën e paraqitjes së ofertave 06.07.2018, KVO duke konsultuar ekstraktin e paraqitur nga ky OE, duhej të kishte konstatuar se oferta dhe të gjitha dokumentat shoqëruese kanë qenë të nënshkruara nga një person i paautorizuar me ligj për përfaqësimin e shoqërisë, dhe duke e kualifikuar atë dhe pranuar ofertën përkatëse e ka favorizuar në mënyrë të kundraligjshme.
4. Kemi arsye serioze të besojmë se OE Omega Optikal, nuk ka përmbushur as kërkesën kualifikuese në lidhje me realizimin e furnizimeve të ngjashme në masën 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës (pika 2.3 (1) e Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit). Për të arritur në këtë konkluzion sjellim argumentat në vijim: Së pari, nga pasqyrat financiare të viteve 2015 dhe 2016 të depozituara në QKB nga OE Omega Optikal, duke iu referuar p.sh. inventarit të datës 31.12.2016 (Aneksi 5 bashkëlidhur kësaj ankese ku janë evidentuar mallrat e ngjashme), rezulton se nga totali i inventarit prej 30.335.528 lekë, mallrat dhe materialet e ngjashme me ato të kërkuara nga AK, të disponuara/lëvruara nga ky operator janë në vlerën 2.383.092 lekë, ose rreth 7.8% e inventarit total. Kjo sasi është shumë e vogël në krahasim me kërkesën e AK për shërbime të ngjashme në shumën 15.056.000 lekë. Së dyti, i referohemi eksperiencës së gjatë dhe të konsoliduar në treg të OE të bashkimit tonë, e cila na dëshmon se mallrat e kërkuara nga AK, të cilat janë të një natyre specifike për përdorim spitalor/kirurgjik në okulistikë nuk janë furnizime të zakonshme të okulistikës

kozmetike/ambulatory nga ato të cilat zenë gamën më të madhe të aktivitetit të OE Omega Optikal, dhe si të tilla nuk rezultojnë që të jenë furnizuar në tregun shqiptar nga OE Omega Optikal në sasi të tilla që të plotësojnë kushtin e furnizimeve të ngjashme. Edhe vetë AK, që është qendra më e madhe spitalore në vend, për herë të parë po zhvillon një procedurë duke kërkuar të tilla sasi të këtyre materialeve. Në rrethanat e mësipërme, cdo dëshmi në formën e faturave të furnizimit tek subjekte private të paraqitura nga OE Omega Optikal duhet parë me dyshim dhe duhet verifikuar nga AK, duke u kërkuar edhe Formularët e Deklarimit dhe të Pagesës së TVSH, për të konfirmuar vërtetësinë dhe rregullshmërinë e tyre.

5. Kemi arsye të dyshojmë se Shtojca 8 e dorëzuar nga OE Omega Optikal ka nevojë për verifikime pranë organeve të administratës tatimore/doganore, për tu siguruar që ky operator i ka shlyer rregullisht të gjitha detyrimet tatimore përfshirë edhe TVSH në import, pasi nga konsultimi i listave të gjyqeve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se nga ky operator janë depozituar 2 padi kundër Degës së Doganës Rinas dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave më datë 19.03.2018 me nr. 31154-01743-80-2018 (Aneks 6) dhe me datë 28.06.2018 me nr. 31154-04113-80-2018 (Aneks 7).
6. OE Omega Optikal nuk plotëson specifikimet teknike të materialeve sic janë kërkuar nga AK. Nga konsultimi i Regjistrat Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore të publikuar në <http://ëëë.akbpm.gov.al/>, rezulton se OE Omega Optikal është i regjistruar si importues i pajisjeve/materialeve mjekësore të kërkuara nga AK për prodhuesit HEILPHARMA (<http://ëëë.heilpharma.com/index.html>), EYECON (<http://ëëë.eyecon.com.my/>), FREEDOM OPHTHALMIC (<http://ëëë.freedomophthalmic.com/>). Nga konsultimi i katalogëve të këtyre prodhuesve dhe informacioneve që kemi për furnizimin e këtij tregu specifik, na rezulton se nga OE Omega Optikal, për një pjesë të materialeve prodhuesit nuk ofrojnë certifikim CE sic është kërkuar në pikën 2.3 (3) të Shtojcës 9 dhe as nuk plotësohen specifikimet teknike të kërkuara nga AK në Shtojcën 10. Më konkretisht mosplotësimet paraqiten në tabelën në vijim:

Nr	Pershkrimi i artikullit	Prodhuesi	Dokumente te munguara	Specifikime te paplotesuara
1	Tripan blu me te pakten 0.06% - 1ml	HEIL	Nuk ka CE. Autodeklarata e kompanise thekson qe nuk ka CE	Nuk ka te dhena te perqindjes se produktit qe eshte mire percaktuar ne specifikime
2	Viskoelastik Dispersiv; Hydroxypropyl methyl cellulose solucion 2 %,-2 ml. Pesha molekulare: 80,000-86,000 daltons; pH: 6.0-7.8. Osmolaliti: 250-350 mosmol/Kg;	EYECON		Nuk eshte 2 ml, eshte 1.5 ml, nuk ka as peshe molekulare, as pH, as osmolaritet te identifikuar ne katalog
3	Viskoelastik Koheziv; 1-1.6% Sodium Hyaluronate me paketim 0.8-1ml; Pesha molekulare: 1.000.000 -3.000.000 daltons pH: 6.8-7.6; Osmolaliti: 260-360 mosmol/Kg;	EYECON		Ska as peshe molekulare, as pH, as osmolaritet te identifikuar ne katalog

4	<i>Thika korneale, sklerale per tynel anesor ne forme V, 20 G</i>	HEIL		
5	<i>Thika Korneale, per tynel anesor me tehun preres 15⁰</i>	HEIL		
6	<i>Thika Korneale per te realizuar tynelin kryesor e harkuar me kend, 3mm</i>	HEIL		
7	<i>Thika Korneale per te realizuar tynelin kryesor, e harkuar me kend, 2,75mm</i>	HEIL		<i>Kompania HEIL nuk ka thika 2.75mm, por vetëm 2.8mm. Pra produkti I ofruar eshte jashte specifikimeve te kerkuara</i>
8	<i>Thika Korneale Kreshente me ken d dhe me teh te dyfishte</i>	HEIL		
9	<i>Retraktor Irisi qe realizon dilatim mekanik te pupiles.</i>	HEIL	<i>Nuk ka CE per kete produkt</i>	
10	<i>Mbulese syri me fibra tekstile qe te mos laget dhe qe sherben per te penguar kontaminirnin e syrit qe do te operohet. Mid-size(Masa M) 100-105cm x 120-130cm incision Oktagonal; Apertura Ovale, adhesive; me 1 Xheper per mbledhjen e likideve;</i>	HEIL		<i>Permase 150-160 e ofruar nga kjo kompani është jashte specifikimeve të kërkuara</i>
11	<i>Lente intraokulare e bute asferike , asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartrixh per injektim, me diameter Optik 6-6.5 mm; Gjatesia maksimale 12 — 13.5 mm; I gjithë diapazoni I Dioptrive te perfshije nga -7D deri ne + 40D</i>	FREEDOM		<i>Artikulli 11 kodi afm606sq tek katalogu FREEDOM. Gjatesia maksimale esht 11 mm, cka eshte jashte specifikimeve te kerkuara. Nuk ka dioptrite nga -7 deri 40</i>
12	<i>Lente intraokulare e forte posteriore hidrofiliqe/hidrofobike; Diametri Optik 5.5 - 6mm; Gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm;</i>	FREEDOM		
13	<i>Lente intraokulare e forte anterior hidrofiliqe/hidrofobike; Diametri Optik 5.5—6 mm; Gjatesia maksimale 8.0-13.5</i>	FREEDOM		

	mm;			
14	Lente intraokulare e perthyeshme asferike, 3 pjese hidrofobike/hidrofilike bikonvekse se bashku me injektorin njeperdorim per injektim, Diametri Optik 5.5-6mm; Gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm; I gjithë diapazoni I Dioptrive te perfshije nga -7D deri ne + 40D	IMB	Nuk ka CE per injektorin	Dioptrite e ofruara jane 0 deri 30. Pra jane jashte specifikimeve te kerkuara - 7 deri ne 40
15	Unaze Kapsulare e hapur me material PMMA me kend 270 grad, Injektori qe perdoret eshte njeperdorimesh	FREEDOM	Nuk ka CE per unazen dhe as per injektorin	Nuk ka injector, nuk ka 270 grade
16	Solucjon BSS 500ml me pH 7,2-7,6 dhe me osmolalitet 298-305.	HEIL	Nuk ka CE. Autodeklarata e kompanise thekson qe nuk kane CE per këtë produkt	Ska as pH, as osmolaritet te identifikuar ne katalog

Nga tabela e mësipërme duket qartë se për 10 nga 16 kategoritë e materialeve të kërkuara nga AK, materialet e ofruara nga prodhuesit për të cilët OE Omega Optikal është regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, ose nuk plotësojnë specifikimet teknike, ose nuk janë të pajisur me certifikim CE, ose të dyja bashkë. Pra, është tërësisht e papranueshme, e kundraligjshme, në dëm të interesit publik dhe shëndetit të qytetarëve si dhe diskriminuese për ne konkurentët e tjerë që sjellim përvojën dhe cilësinë maksimale, që të kualifikohet ky operator dhe të pranohet furnizimi me materiale që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga vetë AK.

Në konkluzion: kërkojmë nga AK Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” të shqyrtojë me seriozitet dhe përgjegjshmëri ligjore këtë ankesë tonën dhe të skualifikojë e të vlerësojë si të papranueshme ofertën e OE Omega Optikal, duke e refuzuar atë[...].

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 3677/4 Prot. datë 06.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ankimues “Pegasus” sh.p.k. & “Gen-Albfarma” sh.p.k., duke mos pranuar ankesën, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Vlerësimi Paraprak:

Gjatë shqyrtimit paraprak, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, për sa i përket legjitimitetit të subjektit dhe afatit të paraqitjes së ankesës pranë AK, KSHA konstatoi se ankesa e paraqitur është brenda afateve ligjore, si dhe është në përputhje me afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor KSHA, konstatoi se ankimi është paraqitur nga OE Ekonomik “Pegasus” shpk.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit pika 1 se OE Omega Optikal nuk ka plotësuar kërkesat e pikës 2.2 (a) të shtojcës 9 të DST ku kërkohet se duhet të paraqiten: Kopje të certifikuar të bilanceve të tre viteve të fundit (2015,2016,2017) të OE pjesëmarrës, të paraqitura në autoritetet pjesëmarrëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet...,’ KSHA konstaton se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik “OMEGA OPTIKAL” ne SPP rezulton se xhiro në vlerë mesatare për periudhën e kërkuar në dokumentat e procedurës e tejkalon vlerën e tenderit Si dhe referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik ku vendosja e kritereve ka si synim kryesor që ti shërbejë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, ekonomike e financiare, organizative, në makineri dhe pajisje si dhe asete të tjera fizike apo personelin e nevojshme, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E shprehur ndër të tjera në nenin 46, (Kualifikimi i Ofertuesve), germa c) gjendja ekonomike e financiare, ku citohet se: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur; të LPP, si dhe VKM nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prnkurimit publik” të ndryshuar, neni 27 (Kontratat e mallrave) pika 5, ku ndër të tjera citohet se: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:a)kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse:dhe/ose b)“kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose” c)një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.(e plotësuar nga OE në SPP). Dhe në interpretim të nenit 46 të LPP si më sipër, apo nenit 27 të RPP, frymës së legjislacionit të prokurimit, KSHA gjykon se KVO ka vlerësuar drejt duke krijuar bindjen se OE “Omega Optikal” shp.k., gëzon potencial ekonomik e financiar për të përmbushur këtë kontratë. Gjithashtu bazuar në vendimin nr. 495, datë 13.09.2017 “Për Miratimin e Rregullave të Përfitimit të Shërbimeve Publike Elektronike”, në seksioni 11, “Përmbajtja dhe Vlefshmëria e Dokumenteve Administrative Elektronike” ku thuhet se : “5. Dokumentet administrative elektronike të përfitohen nga transmetimi elektronik i të dhënave me Vulë elektronike kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si do dokument tjetër zyrtar. 6. Dërgimi dhe pranimi i të dhënave kryhen në përruthje të plotë me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara. 7. Dokumentet administrative elektronike duhet të përmbajnë të paktën: a) të dhënat e kërkuara prej aplikuesit të cilat përfitohen nëpërmjet shërbimit të transmetimit elektronik nga sistemi që disponon bazën e të dhënave b) vulën elektronike të institucionit lëshues të dokumentit c) shënimin në fund të faqes: “Ky dokument është lëshuar nga sistemi elektronik bazuar në bazën e të dhënave shtetërore të institucionit lëshues”. 8. Vulosja e dokumenteve administrative elektronike të gjeneruara nga transmetimi elektronik garanton autenticitetin e dokumentit në formatin elektronik.”, si dhe në njoftimin e Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 14307 prot. dt. 23.11.2017 “Mbi barazvlefshmërinë e dokumenteve administrative elektronike me dokumentet zyrtare”,

KSHA verifikoi dhe konstatoi se Oeratori Ekonomik "OMEGA OPTIKAL" sh.p.k. ka te miratuara dhe publikuar prane QKB pasqyrat financiare (bilancet) 2015, 2016, 2017. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa i përket çështjes së shtruar, ku citohet se oferta e paraqitur nga OE Omega Optikal, nëpërmjet Administratorit të shoqërisë është e paligjshme, pasi Administratorit të shoqërisë i kishte mbaruar afati, sqarojmë se referuar LPP, si dhe DST në nenin 15, procedura e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme bëhet nëpërmjet një autodeklarate me shkrim nga ofertuesi, ndërsa referuar ligjit nr., neni 21 që ju referoni (Efektet e regjistrimit dhe publikimit) në pikën 1 citohet se: Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundrejtohet të tretëve nga dita e publikimit, sipas nenit 61 të këtij ligji, si dhe pika 5: Regjistrimet e regjistrin tregtar vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar për autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ne Kriteret e Përgjithëshme Te Pranimit/Kualifikimit ne DST eshte kerkuar: Ofertuesi duhet të deklarojë se: a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ku në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse". Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër. Sipas përcaktimeve të Nenit 15 të VKM-së Nr 914 date 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik" të ndryshuar citohet "Përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së në vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme" Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, KSHA gjykon se operatori ekonomik "OMEGA OPTIKAL" sh.p.k. plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor lidhur me paraqitjen e akteve që shoqërojnë ofertën e paraqitur nga ky Operator Ekonomik prane AK. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit pika 3 OE Omega Optikal nuk ka përmbushur kërkesën kualifikuese në lidhje me realizimin e furnizimeve të ngjashme në masën 40% të vlerës së perllogaritur : KSHA konstaton se: Në shtojcën 9 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik" e dokumentave të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon: 1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës limit* të kësaj procedure prokurimi të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontrata/kontratat perkatese te shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/te tyre dhe/ose fatura tatimore të shitjes, ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë vetem faturat tatimore te shitjes, ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Operatori Ekonomik "OMEGA OPTIKAL" në përmbushje të kriterëve teknike të mesiperme ka paraqitur në SPP faturat tatimore ku shërbimet e realizuara nga OE janë të ngjashme me objektin e kontratës.

Pretendimi dhe argumentat se OE “Omega Optikal” nuk ka permbushur kerkesen kualifikuese ne lidhje me realizimin e furnizimeve te ngjashme ne masen 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates nuk qendron pasi: 1. Totali i inventarit te dates 31.12.2016 te cilin OE ankimues “Pegasus” ka marre si baze argumentimi nuk perfaqeson ne asnje rast vleren e furnizimeve te ngjashme por vetem stokun (gjendjen fizike te mallrave) ne nje date te caktuar. Mallrat dhe materialet e ngjashme te disponuara (gjendje fizike) ne fund te periudhes ushtrimore nuk mund te merren si baze per vleresimin e shitjeve te realizuara gjate vitit ushtrimor. Realizimi I ketij kushti nga OE “Omega Optikal” eshte kryer nepermjet paraqitjes se faturave tatimore te shitjes ashtu sic. percaktohet ne DST. Autoriteti Kontraktor nuk e ka te nevojshme te kerkoje FDP se TVSH, per te konfirmuair vertetesine e faturave te shitjes, pasi te ardhurat nga shitjet jane te konfirmuara ne vertetimin e xhiros se leshuar nga Organet Tatimore. Te ardhurat e deklaruar gjate vitit jane shume e FDP se tvsh gjate 12 muajve te vitit. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Lidhur me pretendimin e ankimuesit pika 4 se Shtojca 8 e dorezuar nga OE Omega Optikal ka nevojë per verifikime prane organeve te administrates Tatimore KSHA konstaton se: Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” te dokumentave të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon: Ofertuesi duhet te deklaroje ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Nga verifikimi ne SPP te dokumentacionit te paraqitur ne permbushje te kerkesave te kerkuara ne DST Operatori Ekonomik “OMEGA OPTIKAL” rezulton se ka paraqitur Deklaraten per Permbushje te Krieteve te Pergjithshme sipas te ciles Operatori ekonomik “OMEGA Optikal” ka paguar te gjitha detyrime per pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi, sipas percaktimeve te Nenit 15 te VKM-së Nr 914 date 29.12.2014 “Regullat e Prokurimit Publik” te ndryshuar citohet “Përmbushja e krieteve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nepermjet paralitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se Operatori Ekonomik “OMEGA OPTIKAL” ka procese gjyqesore me Institucione Shteterore (DPD dhe Dega e Doganes Durres) nuk perben shkak per skualifikim pasi qenia ne procese gjyqesore te Operatoreve te ndyshem ekonomike pjesmarres ne kete procedure prokurimi nuk eshte kusht skualifikues per proceduren objekt ankimi; Ne DST, AK ne perputhje me objektin e tenderimit ka vendosur kriete te cilat i gjykon se permbushin dhe realizojne kontraten. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Lidhur me pretendimin e Operatorit Ankimues se OE “OMEGA OPTIKAL” nuk ploteson specifikimet ne kerkuara ne DST nga AK, KSHA gjykon se: Argumentimi ku e mbeshtet pretendimin e vet OE ankimues jane konsultimi me kataloget e prodhuesve HEILPHARMA, FREDOOM, OPHTAHALMIC dhe EYECON subjekt impartues i te cileve eshte OE “OMEGA OPTIKAL”. Argumenti mbeshtetet mbi supozime dhe indicie nga kataloget e firmave prodhuese, nderkohe qe ky argument nuk perputhet me dokumentacionin e pasqyruar ne SPP nga OE “OMEGA OPTIKAL” Pretendimet e Operatorit Ekonomike Pegasus LTD” Shpk, nuk kane asnjë lloj dokumentacioni tekniko ligjor apo prove të shkruar që të vërtetojë pretendimet e ankimuesit apo të ndihmojë AK' në thellimin e hetimit administrativ për të dhënë një përgjigje bazuar në lex specialis dhe parimin stricti iuris. Në këtë kuptim, referuar dispozitave te Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 12 ku citohet se: “Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj”, neni 14 (Parimi i Objektivitetit) ku citohet se:

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”, nenit 47 (E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime) ku citohet se: “Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”, nenit 78 (Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ), pika 1 ku citohet se: “Pala bashkëpunon me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Ligji mund të parashikojë shprehimisht detyrimin e mëtejshëm të palës për të paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t’u paraqitur personalisht përpara organit publik”, si dhe nenit 82 (Barra e provës), pika 1 ku citohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”, për çështjen në fjalë objekt shqyrtimi, lidhur me pretendimet e OE “PEGASUS LTD” shpk., ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës (kur barra e provës i bie kërkuarit) dhe OE ankimues në asnjë rast nuk ka sqaruar, argumentuar dhe më pas provuar me dokumente shtesë (por vetëm referuar dhe mbi bazën e pretendimeve) faktin e mosdorëzimit të dokumentacionit sipas formave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, apo faktin nëse pajisjet e cituara në ankesë nuk janë sipas formave të kërkuara etj. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.[...]”

II.6. Në datën 15.08.2018 pala ankimuese BOE “Pegasus” sh.p.k. & “Gen-Albfarma” sh.p.k. ka paraqitur për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, në të cilën argumenton si më poshtë vijon:

[...]

Pretendimi jonë nr.1

OE Omega Optikal nuk ka plotësuar kërkesat e pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit ku kërkohet që për qëllime kualifikimi OE duhet të paraqesin: “Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të jimit (2015, 2016, 2017), të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet. Mbështetur në VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004” Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar”, bilanci duhet të depozitohet në organet tatimore jo më vonë se data 31 Mars e vitit pasardhës, ndërsa bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, neni 43, pika (a), bilancet duhen depozituar në QKB jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Duke iu referuar ekstraktit historik të shoqërisë Omega Optikal të datës 24.07.2018 (Aneksi 4), rezulton se Bilancet e vitit 2015 dhe 2016 të kësaj shoqërie janë të pakonfirmuara nga tatimet, ndërsa Bilanci i vitit 2017 nuk është fare i depozituar në QKB. Në këto rrethana, për shkak të mosdepozitimit të bilanceve sipas kërkesës së pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit, KVO duhej ta kishte skualifikuar këtë operator dhe të mos pranonte ofertën e tij.

Përgjigja e AK

“Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik “OMEGA OPTIKAL” ne SPP rezulton se xhiro në vlerë mesatare për periudhën e kërkuar në dokumentat e procedures e tejkalon vleren e tenderit Si dhe referuar frymës së legjislacionit për prokurimin

publik ku vendosja e kriterëve ka si synim kryesor që ti shërbejë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, ekonomike e financiare, organizative, në makineri dhe pajisje si dhe asete të tjera fizike apo personelin e nevojshme, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E shprehur ndër të tjera në nenin 46, (Kualifikimi i Ofertuesve), germa c) gjendja ekonomike e financiare, ku citohet se: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur; të LPP, si dhe VKM nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prnkurimit publik” të ndryshuar, neni 27 (Kontratat e mallrave) pika 5, ku ndër të tjera citohet se: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose” c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (e plotësuar nga OE në SPP). Dhe në interpretim të nenit 46 të LPP si më sipër, apo nenit 27 të RPP, frymës së legjislacionit të prokurimit, KSHA gjykon se KVO ka vlerësuar drejt duke krijuar bindjen se OE “Omega Optikal” shp.k., gëzon potencial ekonomik e financiar për të përmbushur këtë kontratë. Gjithashtu bazuar në vendimin nr. 495, datë 13.09.2017 “Për Miratimin e Rregullave të Përfitimit të Shërbimeve Publike Elektronike”, në seksionin 11, “Përmbajtja dhe Vlefshmëria e Dokumenteve Administrative Elektronike” ku thuhet se : “5. Dokumentet administrative elektronike të përfitohen nga transmetimi elektronik i të dhënave me Vulë elektronike kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si do dokument tjetër zyrtar. 6. Dërgimi dhe pranimi i të dhënave kryhen në përruthje të plotë me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara. 7. Dokumentet administrative elektronike duhet të përmbajnë të paktën: a) të dhënat e kërkuara prej aplikuesit të cilat përfitohen nëpërmjet shërbimit të transmetimit elektronik nga sistemi që disponon bazën e të dhënave b) vulën elektronike të institucionit lëshues të dokumentit c) shënimin në fund të faqes: “Ky dokument është lëshuar nga sistemi elektronik bazuar në bazën e të dhënave shtetërore të institucionit lëshues”. 8. Vulosja e dokumenteve administrative elektronike të gjeneruara nga transmetimi elektronik garanton autenticitetin e dokumentit në formatin elektronik.”, si dhe në njoftimin e Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 14307 prot. dt. 23.11.2017 “Mbi barazvlefshmërinë e dokumenteve administrative elektronike me dokumentet zyrtare”, KSHA verifikoi dhe konstatoi se Operatori Ekonomik “OMEGA OPTIKAL” sh.p.k. ka të miratuara dhe publikuar pranë QKB pasqyrat financiare (bilancet) 2015, 2016, 2017. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.”

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë se:

Qëndrimi i mësipërm i KSHA është absurd, tërësisht i kundraligjshëm dhe një avokati haptazi jo vetëm për KVO, por edhe për të justifikuar dhe mbuluar dështimin e OE Omega Optikal për përmbushjen e kërkesave të pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit!!! Në mënyrë të qartë ne kemi ngritur pretendimin se referuar ekstraktit historik të shoqërisë Omega Optikal të

datës 24.07.2018, rezulton se Bilancet e vitit 2015 dhe 2016 të kësaj shoqërie janë të pakonfirmuara nga tatimet, ndërsa Bilanci i vitit 2017 nuk është fare i depozituar në QKB. Nga përgjigjia e KSHA, kuptojmë se jo vetëm pretendimi jonë është i saktë, por këto bilance nuk janë dorëzuar fare nga ky OE në SPE, dhe KSHA tenton ta justifikojë kualifikimin e këtij OE, pavarësisht nga kjo mangësi thelbësore, pra pavarësisht nga mungesa fizike e dokumentacionin kualifikues në SPE, duke bërë sofizma në lidhje me nevojën ose jo të aplikimit të detyrueshëm të kësaj kërkesë. Sqarojmë se arsyetimi i KSHA mund të ketë vlerë nëse jemi në fazën e kundërshtimit të Dokumentave të Tenderit, por për sa kohë Dokumentat e Tenderit, përfshirë kërkesat për kualifikim, janë të miratuara, të shpallura dhe jemi në fazën e vlerësimit të ofertave, KVO dhe KSHA kanë detyrimin e thjeshtë të verifikojnë në mënyrë kumulative vetëm sa vijon: A janë paraqitur të gjitha dokumentat e kërkuara në Dokumentat e Tenderit për qëllime kualifikimi? A plotësojnë të gjitha dokumentat e paraqitura kërkesat për kualifikim? Sa më sipër është e qartë edhe nga vetë Dokumentat e Tenderit ku në faqen 28, përcaktohet qartë se: "Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim " Edhe justifikimi i KSHA duke thirrur në ndihmë VKM nr. 495, datë 13.09.2017 "Për Miratimin e Rregullave të Përfitimit të Shërbimeve Publike Elektronike" është krejtësisht i pavend, aq më tepër kur KSHA duke tejkalluar kompetencat dhe detyrat e veta shprehet se: "KSHA verifikoi dhe konstatoi se Operatori Ekonomik "OMEGA OPTIKAL" sh.p.k ka te miratuara dhe publikuar prane QKB pasqyrat financiare(bilancet) 2015,2016,2017. ". Vendimin për skualifikimin apo kualifikimin e një OE e merr KVO dhe jo KSHA, detyra e së cilës është të thjeshtë të verifikojë pretendimet e ankimuesit dhe jo të argumentojë vendimin e KVO me fakte të ngjara pas vendimmarrjes së KVO. Nga verifikimi jonë në QKB, rezulton se këto bilance janë publikuar më datë 26.07.2018, pra 3 ditë pasi KVO kishte mbyllur vendimmarrjen e vet për kualifikimin (të kundraligjshëm duhet të shtojmë) të OE Omega Optikal. Faktet e ngjara pas kësaj datë nuk mund të përdoren nga KSHA për të justifikuar vendimmarrjen e KVO, e cila sidoqoftë duhet të bazohet vetëm në dokumentacionin e paraqitur nga OE në SPE si pjesë e ofertës. Edhe mënyra e trajtimit të këtij pretendimi tonë, tregon për njëanshmëri dhe favorizim haptazi nga KVO dhe KSHA të këtij operatori dhe njëkohësisht shkelje të barazisë dhe diskriminim të operatorëve të tjerë konkurues, të cilët kanë treguar kujdesin maksimal për dorëzimin e plotë dhe të saktë të ofertës së tyre.

Pretendimi jonë nr.2

KVO e AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 56 (1) dhe 57 (1) të Ligjit Për Prokurimin Puka dhe nenit 66 (3), (5) të VKM "Për rregullat e prokurimit publik", me mënyrën se si ka vepruar me verifikimin e ofertës së OE Omega Optikal si ofertë anomalisht e ulët. Nga konsultimi i SPE vërejmë se në datë 23.07.2018, pra në të njejtën ditë kur është njoftuar kualifikimi dhe renditja e ofertave, është hedhur në sistem kërkesa e KVO të AK për sqarime nga OE Omega Optikal për ofertë të konsideruar anomalisht të ulët dhe në të njejtën ditë ky OE kthen përgjigje në sistem, përgjigje e cila është vetëm kaq: "Pershendetje. Cmimet e ofruara janë me konkuresë! dhe te ulta ngaqe si operator i ri duam te jemi pjese e tregut, dhe kjo dhe me mbeshitetjen e kompanive furnizuese. Omega optikal punon kryesisht me operatore privat, dhe per te kete kete tender e shikon si mundesi per hyrjen dhe ne tregun e spitaleve.

Omega optika mer persiper ofrimin e materialeve te kerkuare nga ju sipas specifikimeve perkatese me cmimet e oferte se paraqitur nga ana jone, shpresoj ne mirekuptimin tuaj. " Duket se kjo përgjigje ka qenë e mjaftueshme për KVO e AK për të kualifikuar këtë OE dhe për të pranuar ofertën e tij me gjithë vlerën anomalisht të ulët dhe parregullsitë dhe mosplotësimet e listuara më sipër.

Mënyra e mësipërme e trajtimit të sqarimeve për ofertën anomalisht të ulët është tërësisht në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara. Së pari, sipas nenit 56 (1) të LPP, kërkesa e AK për operatorin me ofertë anomalisht të ulët duhet bërë në mënyrë shkresore dhe jo duke u hedhur në sistem, pasi kështu është shkelur neni 57 (1) i LPP. Së dyti, sic përcakton neni 56 (1) i LPP, AK duhet ti kërkonte këtij operatori në mënyrë të detajuar shpjegime për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e mallrave; c) origjinalitetin e mallrave të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të sigurohet furnizimi. Në fakt AK nuk e ka bërë kërkesën në këtë mënyrë sic kërkohet nga ligji. Së treti, sipas nenit 66 (5) të VKM "Për rregullat e prokurimit publik", ofertuesi të cilit i kërkohej sqarimet për ofertën anomalisht të ulët, jo vetëm duhet të përgjigjet në formë shkresore (çka nuk rezulton të ketë ndodhur), por për më tepër "ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shbesore sqarime! për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LP Asnjë argumentim konkret nuk është bërë nga ky ofertues, dhe as nuk janë paraqitur prej tij prova shkresore që të sqarojnë elementët e veçanta të ofertës së tij sic kërkohet nga ligji. Ky ofertues është mjaftuar me një paragraf të përgjithshëm të hedhur në sistem që nuk sqaron asgjë dhe çka është më e papranueshme dhe tërësisht e kundraligjshme është që ky lloj "sqarimi" në mënyrë të papërgjegjshme është konsideruar i mjaftueshëm nga AK.

Përgjigja e AK:

AK nuk e ka shqyrtuar dhe nuk i ka dhënë fare përgjigje këtij pretendimi të rëndësishëm tonin.

Në lidhje me dështimin e AK, për ti dhënë përgjigje këtij pretendimi shtojmë se:

Cmimi tepër i ulët i ofruar nga OE Omega Optikal është një reflektim i qartë i cilësisë së dobët, jashtë standarteve dhe jo në përputhje me specifikimet teknike të mallrave të ofertuara nga ky OE. Duhet të mbajmë parasysh, se në procedurën konkrete kemi të bëjmë me materiale mjekësore delikate për tu përdorur në procedura kirurgjikale, pra edhe papërgjegjshmëria më e vogël në këtë procedurë do të ndikojë negativisht në jetën dhe shëndetin e qytetarëve shqiptarë. Ne shpresojmë që qytetarët taksapagues shqiptarë, të mos konsiderohen qytetarë të rangut të 3 a të 4, sic janë mallrat që AK këmbëngul të marrë nga OE Omega Optikal, vetëm sepse cmimi është i ulët. Sigurisht oferta financiare synohet nga AK të përftohet e leverdishme dhe me ulje nga fondi limit, por një ulje e përmasave të tilla është nuk është cmim konkurrues, është thjesht një ofertë anomalisht e ulët për shkak të mosplotësimin të standarteve të cilësisë dhe specifikimeve teknike, ofertë e cila duhet të refuzohet jo vetëm si e skualifikuar, por si e papërgjegjshme. Që të jemi sa më objektive, po citojmë rreziqet që vijnë nga pranimi abuziv i ofertave anomalisht të ulëta, sic janë vlerësuar edhe nga SIGMA në Udhëzimin nr.35 të vitit 2016 "Ofertat anomalisht të ulëta", të cilin e bashkëlidhim me këtë ankesë si Aneks 10 "Risqet që lidhen me zgjedhjen e ofertës anomalisht të ulët Dhënia e kontratës një operatori ekonomik që paraqet një ofertë anomalisht të ulët është e rrezikshme për autoritetin kontraktor (dhe në përgjithësi për interesin publik) për një numër arsyesh, si më poshtë vijon. Risku i paracaktuar: Një ofertë anomalisht e ulët nënkupton një rrezik të paracaktuar, veçanërisht në rastin e një operatori ekonomik që e ka keqkuptuar kompleksitetin e prokurimit apo nuk ka marrë parasysh të gjitha rreziqet që lidhen me dhënien e objektit të prokurimit.

Rezultati mund të jetë që operatori ekonomik nuk do të jetë në gjendje që të realizojë kontratën, ose edhe do të humbasë aftësinë paguese. Autoriteti kontraktor do t'i duhet pastaj të ri-tenderojë shërbimet ose punët që operatori ekonomik ka dështuar për të ofruar. Rezultati do të jetë kohë e humbur, si dhe administrimin shtesë dhe shpenzime të bëra nga autoriteti kontraktor. Tarifat shtesë ose rritjet e çmimeve:

Operatori ekonomik që është zgjedhur në bazë të ofertës shumë të ulët mund të kërkojë në rrjedhën e realizimit të kontratës që t'i ngarkojë autoritetit kontraktor kosto shtesë dhe të kërkojë rritjen e shpërblimit. Gjatë fazës së realizimit të kontratës, pozicioni i negocimit të operatorit ekonomik shpesh është i fortë. Për shembull, një operator ekonomik mund të kërkojë pagesa shtesë të cilat nuk janë të përfshira në kontratë dhe kërcënon të zgjidhë kontratën nëse autoriteti kontraktor nuk pajtohet me këto pagesa shtesë. Risku i cilësisë: Një risk tjetër është se mallrat ose shërbimet e ofruara do të jenë të një cilësie më të ulët se ato duhet të kenë në përputhje me kushtet e kontratës. Për shembull, një operator ekonomik që kishte propozuar një ofertë shumë të ulët mund të përpiqet që të mashtrtojë autoritetin kontraktor duke zëvendësuar materiale të cilësisë së lartë me zëvendësues më të lirë, ose duke mos kryer të gjitha shërbimet e kërkuara. Shmangia e detyrimeve sociale, të punës dhe mjedisore: Oferta anomalisht të ulët ka edhe një rrezik tjetër që rregullat e detyrueshme sociale, të punës dhe mjedisit nuk do të zbatohen në mënyrë korrekte. Për shembull, operatori ekonomik do të përpiqet që të shmangë pagimin e taksave që duhen paguar, pagën minimale apo detyrat shoqërore. Si pasojë, tregu do të shtrembërohet dhe kompanitë e ndershme që i binden ligjit do të dekurajohen nga aplikimi për kontrata publike. Në afat të gjatë, konkurrenca pëson ulje, pasi në procedurat e prokurimit marrin pjesë një numër i vogël i firmave, dhe nga ana tjetër, çmimet janë të fryra.[...]

Pretendimi jonë nr.3

Oferta e OE Omega Optikal është paraqitur e nënshkruar nga një person, i cili në momentin e paraqitjes së saj më datë 06.07.2018, nuk ka qenë i autorizuar ligjrisht për të përfaqësuar rregullisht këtë shoqëri në marrëdhënie me të tretët, konkretisht AK. Nga ekstrakti historik i shoqërisë Omega Optikal (Aneks 4 bashkëlidhur kësaj ankese), rezulton se mandati i Administratorit të kësaj shoqërie (Ardian Njehrrëna) ka mbaruar më datë 23.06.2018. Po sipas këtij ekstrakti historik, rezulton se më datë 18.07.2018, pra 12 ditë pas hapjes së ofertave, në QKB është dorëzuar aplikimi me nr. CN-877244-07-18 për regjistrimin e Vendimit të datës 24.06.2018(! !) për zgjatjen e afatit të Administratorit nga data 24.06.2018 deri më datë 23.06.2023. Nenet 12 dhe 95 të Ligjit 9901/2018 dhe neni 21 i Ligjit 9723/2007 të sipërcituara, tregojnë qartë se emërimi i Administratorit mund tu kundrejtohet palëve të treta vetëm pas regjistrimit të këtij emërimi në QKB, pra në rastin konkret vetëm pas datës 24.07.2018. Ky aplikim është regjistruar dhe publikuar në QKB në Regjistrin Tregtar më datë 24.07.2018, pra është e qartë se në datën e paraqitjes së ofertave 06.07.2018, KVO duke konsultuar ekstraktin e paraqitur nga ky OE, duhej të kishte konstatuar se oferta dhe të gjitha dokumentat shoqëruese kanë qenë të nënshkruara nga një person i paautorizuar me ligj për përfaqësimin e shoqërisë, dhe duke e kualifikuar atë dhe pranuar ofertën përkatëse e ka favorizuar në mënyrë të kundraligjshme.

Përgjigja e AK

“...sqarojmë se referuar LPP, si dhe DST në nenin 15, procedura e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme bëhet nëpërmjet një autodeklarate me shkrim nga ofertuesi, ndërsa referuar ligjit nr., neni 21 që ju referoni (Efektet e regjistrimit dhe publikimit) në pikën 1 citohet se: Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundrejtohet të tretëve nga dita e publikimit, sipas nenit 61 të këtij ligji, si dhe pika 5: Regjistrimet e regjistrin tregtar vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar për autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ne Kriteret e Përgjithëshme Te Pranimit/Kualifikimit ne DST eshte kerkuar: Ofertuesi duhet të deklarojë se: a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ku në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse". Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër. Sipas përcaktimeve të Nenit 15 të VKM-së Nr 914 date 29.12.2014 "Regullat e Prokurimit Publik" të ndryshuar citohet "Përmbushja e kritereve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së në vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme" Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, KSHA gjykon se operatori ekonomik "OMEGA OPTIKAL" sh.p.k. plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor lidhur me paraqitjen e akteve që shoqerojnë ofertën e paraqitur nga ky Operator Ekonomik pranë AK. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron."

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë se:

Pretendimi i ngritur nga ana jonë është ngushtësisht i lidhur me momentin e paraqitjes së ofertës dhe të gjithë dokumentacionit shoqërues për kualifikim, pra gjëndjen faktikë më datë 06.07.2018. Në këtë datë, nga ekstrakti i Regjistrimit Tregtar që KVO ka pasur për shqyrtim (pra me informacionet deri në këtë datë), rezulton se z.Njehrrëna nuk ka pasur tagra për nënshkrimin e ofertës. Cdo e dhënë e depozituar dhe e publikuar pas kësaj datë në ekstrakt dhe Regjistrin Tregtar nuk mund të ishte e njohur nga KVO në datën e hapjes së ofertave. Madje, deri në datën 23.07.2018 kur është bërë njoftimi i klasifikimit dhe i renditjes në SPE, z.Njehrrëna vijonte të rezultonte me mandat administratori të mbaruar. Njoftimi në Regjistrin Tregtar për ndryshimin e administratorit është bërë vetëm 1 ditë pas njoftimit në SPE të klasifikimit, pra më datë 24.07.2018. Pra, minimalisht, KVO duhej të kishte kryer verifikime për vërtetësinë e vetëdeklarimit të OE Omega Optikal sipas nenit 15 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të cituar nga KSHA në përgjigjen e vet. Moskryerja e këtyre verifikimeve nga KVO, në kushtet e dhëna nga momenti i hapjes së ofertave dt.06.07.2018 deri në momentin e njoftimit në SPE dt.23.07.2018, dhe marrja prej KVO si të mirëqena të të dhënave që nuk rezultojnë në dokumentacionin e dorëzuar nga ky OE në SPE, por as në regjistra të tjerë publikë, tregon për njëanshmëri dhe favorizim haptazi nga KVO të këtij operatori dhe njëkohësisht shkelje të barazisë dhe diskriminim të operatorëve të tjerë konkures, të cilët kanë treguar kujdesin maksimal për dorëzimin e plotë dhe të saktë të ofertës së tyre. Ndërsa, justifikimi nga ana e KSHA i veprimeve të KVO, tregon qartë për rakordim të qëndrimeve të tyre dhe mungesë paanësie të KSHA.

Pretendimi jonë nr.4

Kemi arsye serioze të besojmë se OE Omega Optikal, nuk ka përmbushur as kërkesën kualifikuese në lidhje me realizimin e furnizimeve të ngjashme në masën 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës (pika 2.3 (1) e Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit). Për të arritur në këtë konkluzion sjellim argumentat në vijim: Së pari, nga pasqyrat financiare të viteve 2015 dhe 2016 të depozituara në QKB nga OE Omega Optikal, duke iu referuar p.sh. inventarit të datës 31.12.2016 (Aneksi 5 bashkëlidhur kësaj ankese ku janë evidentuar mallrat e ngjashme), rezulton se nga totali i inventarit prej 30.335.528 lekë, mallrat dhe materialet e ngjashme me ato të kërkuara nga AK, të disponuara/lëvruara nga ky operator janë në vlerën 2.383.092 lekë, ose rreth 7.8% e inventarit

total. Kjo sasi është shumë e vogël në krahasim me kërkesën e AK për shërbime të ngjashme në shumën 15.056.000 lekë. Së dyti, i referohemi eksperiencës së gjatë dhe të konsoliduar në treg të OE të bashkimit tonë, e cila na dëshmon se mallrat e kërkuara nga AK, të cilat janë të një natyre specifike për përdorim spitalor/kirurgjik në okulistikë nuk janë furnizime të zakonshme të okulistikës kozmetike/ambulatore nga ato të cilat zenë gamën më të madhe të aktivitetit të OE Omega Optikal, dhe si të tilla nuk rezultojnë që të jenë furnizuar në tregun shqiptar nga OE Omega Optikal në sasi të tilla që të plotësojnë kushtin e furnizimeve të ngjashme. Edhe vetë AK, që është qendra më e madhe spitalore në vend, për herë të parë po zhvillon një procedurë duke kërkuar të tilla sasi të këtyre materialeve. Në rrethanat e mësipërme, cdo dëshmi në formën e faturave të furnizimit tek subjekte privatë të paraqitura nga OE Omega Optikal duhet parë me dyshim dhe duhet verifikuar nga AK, duke u kërkuar edhe Formularët e Deklarimit dhe të Pagesës së TVSH, për të konfirmuar vërtetësinë dhe rregullshmënnë e tyre.

Përgjigja e AK

“...“OMEGA OPTIKAL” ne permbushje te kriterave teknike te mesiperme ka paraqitur ne SPP faturat tatimore ku sherbimet e realizuara nga OE jane te ngjashme me objektin e kontrates. Pretendimi dhe argumentat se OE “Omega Optikal” nuk ka permbushur kerkesen kualifikuese ne lidhje me realizimin e furnizimeve te ngjashme ne masen 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates nuk qendron pasi: 1. Totali i inventarit te dates 31.12.2016 te cilin OE ankimues “Pegasus” ka marre si baze argumentimi nuk perfaqeson ne asnje rast vleren e furnizimeve te ngjashme por vetem stokun (gjendjen fizike te mallrave) ne nje date te caktuar. Mallrat dhe materialet e ngjashme te disponuara (gjendje fizike) ne fund te periudhes ushtrimore nuk mund te merren si baze per vleresimin e shitjeve te realizuara gjate vitit ushtrimor. Realizimi I ketij kushti nga OE “Omega Optikal” eshte kryer nepermjet paraqitjes se faturave tatimore te shitjes ashtu sic. percaktohet ne DST. Autoriteti Kontraktor nuk e ka te nevojshme te kerkoje FDP se TVSH, per te konfirmuair vertetesine e faturave te shitjes, pasi te ardhurat nga shitjet jane te konfirmuara ne vertetimin e xhiros se leshuar nga Organet Tatimore. Te ardhurat e deklaruar gjate vitit jane shume e FDP se tvsh gjate 12 muajve te vitit. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.”

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë se:

Sigurisht, ne nuk e kemi ngritur me siguri të plotë dyshimin tonë, por duke qenë operatorët kryesorë dhe prej vitesh në tregun e materialeve specifike të kërkuara në këtë tender, kemi të dhëna se nga ana e OE Omega Optikal ka pasur një volum jo të zakonshëm dhe ta pajustificuar shitjesh në subjekte privatë vetëm gjatë 1-2 muajve të fundit para datës së hapjes së tenderit. Në dobi, të verifikimit të seriozitetit, historikut dhe kapacitetit real të këtij OE, ne sugjeruam që do ishte me vend verifikimi i FDP të TVSH, për të pasur siguri maksimale që nuk kemi të bëjmë me shitje fiktive të realizuara vetëm për të arritur kuotën e kërkuar për këtë tender të furnizimeve të ngjashme.

Pretendim jonë nr.5

Kemi arsye të dyshojmë se Shtojca 8 e dorëzuar nga OE Omega Optikal ka nevojë për verifikime pranë organeve të administratës tatimore/doganore, për tu siguruar që ky operator i ka shlyer rregullisht të gjitha detyrimet tatimore përfshirë edhe TVSH në import, pasi nga konsultimi i listave të gjyqeve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se nga ky operator janë depozituar 2 padi kundër Degës së Doganës Rinas dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave më datë 19.03.2018 me nr. 31154-01743-80-2018 (Aneks 6) dhe me datë 28.06.2018 me nr. 31154-04113-80-2018 (Aneks 7)

Përgjigj e AK

“Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” te dokumentave të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon: Ofertuesi duhet të deklarojë ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Nga verifikimi ne SPP te dokumentacionit te paraqitur ne permbushje te kerkesave te kerkuara ne DST Operatori Ekonomik “OMEGA OPTIKAL” rezulton se ka paraqitur Deklaraten per Permbushje te Krieteve te Pergjithshme sipas te ciles Operatori ekonomik “OMEGA Optikal” ka paguar te gjitha detyrime per pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi, sipas percaktimeve te Nenit 15 te VKM-së Nr 914 date 29.12.2014 “Regullat e Prokurimit Publik” te ndryshuar citohet “Përmbushja e krieteve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nepermjet paralitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se Operatori Ekonomik “OMEGA OPTIKAL” ka procese gjyqesore me Institucione Shteterore (DPD dhe Dega e Doganes Durrës) nuk perben shkak per skualifikim pasi qenia ne procese gjyqesore te Operatoreve te ndyshem ekonomike pjesmarres ne kete procedure prokurimi nuk eshte kusht skualifikues per proceduren objekt ankimi; Ne DST, AK ne perputhje me objektin e tenderimit ka vendosur kriteret e cilat i gjykon se permbushin dhe realizojne kontraten. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron”

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë se:

Njësoj si në lidhje me pretendimin tonë nr.3, ne nuk e kemi ngritur me siguri të plotë dyshimin tonë, por duke marrë shkas nga indiciet që na rezultuan për gjykime në vijim që mund të kenë të bëjnë me detyrime fiskale, ne sugjeruam që do ishte me vend verifikimi i Vetëdeklarimit të OE Omega Optikal për mospasje të detyrimeve fiskale të pashlyera. Sigurisht, verifikimi ose jo i vetëdeklarimit është kompetencë diskreciale e KVO, por me sa duket në rastin konkret AK në përgjithësi nuk ka asnjë vullnet të sigurohet për kualifikimin e këtij OE, por është vënë në shërbim të plotë të tij për ta kualifikuar edhe pse në kundërshtim të hapur me ligjin dhe aktet nënligjore.

Pretendimi jonë nr.6

OE Omega Optikal nuk plotëson specifikimet teknike të materialeve sic janë kërkuar nga AK. Nga konsultimi i Regjistrimit Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore të publikuar në <http://ëëë.akbpm.gov.al/>, rezulton se OE Omega Optikal është i regjistruar si importues i pajisjeve/materialeve mjekësore të kërkuara nga AK për prodhuesit HEILPHARMA (<http://ëëë.heilpharma.com/index.html>), EYECON (<http://ëëë.eyecon.com.my/>), FREEDOM OPHTHALMIC (<http://ëëë.freedomophthalmic.com/>). Nga konsultimi i katalogëve të këtyre prodhuesve dhe informacioneve që kemi për furizimin e këtij tregu specifik, na rezulton se nga OE Omega Optikal, për një pjesë të materialeve prodhuesit nuk ofrojnë certifikim CE sic është kërkuar në pikën 2.3 (3) të Shtojcës 9 dhe as nuk plotësohen specifikimet teknike të kërkuara nga AK në Shtojcën 10. Më konkretisht mosplotësimet paraqiten në tabelën në vijim:

Nr	Pershkrimi i artikullit	Prodhuesi	Dokumente te munguara	Specifikime te paplotesuara
1	Tripan blu me te pakten 0.06% - 1ml	HEIL	Nuk ka CE. Autodeklarata e kompanise thekson qe nuk ka CE	Nuk ka te dhena te perqindjes se produktit qe eshte mire percaktuar ne specifikime

2	Viskoelastik Dispersiv; Hydroxypropyl methyl cellulose solucion 2 %,-2 ml. Pesha molekulare: 80,000-86,000 daltons; pH: 6.0-7.8. Osmolaliti: 250-350 mosmol/Kg;	EYECON		Nuk eshte 2 ml, eshte 1.5 ml, nuk ka as peshe molekulare, as pH, as osmolaritet te identifikuar ne katalog
3	Viskoelastik Koheziv; 1-1.6% Sodium Hyaluronate me paketim 0.8-1ml; Pesha molekulare: 1.000.000 -3.000.000 daltons pH: 6.8-7.6; Osmolaliti: 260-360 mosmol/Kg;	EYECON		Ska as peshe molekulare, as pH, as osmolaritet te identifikuar ne katalog
4	Thika korneale, sklerale per tynel anesor ne forme V, 20 G	HEIL		
5	Thika Korneale, per tynel anesor me tehun preres 15 ⁰	HEIL		
6	Thika Korneale per te realizuar tynelin kryesor e harkuar me kend, 3mm	HEIL		
7	Thika Korneale per te realizuar tynelin kryesor, e harkuar me kend, 2,75mm	HEIL		Kompania HEIL nuk ka thika 2.75mm, por vetëm 2.8mm. Pra produkti I ofruar eshte jashte specifikimeve te kerkuara
8	Thika Korneale Kreshente me kend dhe me teh te dyfishte	HEIL		
9	Retraktor Irisi qe realizon dilatim mekanik te pupiles.	HEIL	Nuk ka CE per produkt	
10	Mbulesë syri me fibra tekstile qe te mos laget dhe qe sherben per te penguar kontaminirnin e syrit qe do te operohet. Mid-size(Masa M) 100-105cm x 120-130cm incision Oktagonal; Apertura Ovale, adhesive; me 1 Xheper per mbledhjen e likideve;	HEIL		Permase 150-160 e ofruar nga kjo kompani është jashte specifikimeve të kerkuara
11	Lente intraokulare e bute asferike , asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartrixh per injektim, me diameter Optik 6-6.5 mm; Gjatesia maksimale 12 — 13.5 mm; I gjithë diapazoni I Dioptrive te	FREEDOM		Artikulli 11 kodi afm606sq tek katalogu FREEDOM. Gjatesia maksimale esht 11 mm, cka eshte jashte specifikimeve te kerkuara. Nuk ka dioptrite nga -7 deri 40

	perfshije nga -7D deri ne + 40D			
12	Lente intraokulare e forte posteriore hidrofilike/hidrofobike; Diametri Optik 5.5 - 6mm; Gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm;	FREEDOM		
13	Lente intraokulare e forte anterior hidrofilike/hidrofobike; Diametri Optik 5.5—6 mm; Gjatesia maksimale 8.0-13.5 mm;	FREEDOM		
14	Lente intraokulare e perthyeshme asferike, 3 pjese hidrofobike/hidrofilike bikonvekse se bashku me injektorin njeperdorim per injektim, Diametri Optik 5.5-6mm; Gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm; I gjithe diapazoni I Dioptrive te perfshije nga -7D deri ne + 40D	IMB	Nuk ka CE per injektorin	Dioptrite e ofruara jane 0 deri 30. Pra jane jashte specifikimeve te kerkuara - 7 deri ne 40
15	Unaze Kapsulare e hapur me material PMMA me kend 270 grad, Injektori qe perdoret eshte njeperdorimesh	FREEDOM	Nuk ka CE per unazen dhe as per injektorin	Nuk ka injector, nuk ka 270 grade
16	Solucjon BSS 500ml me pH 7,2-7,6 dhe me osmolalitet 298-305.	HEIL	Nuk ka CE. Autodeklarata e kompanise thekson qe nuk kane CE per ketë produkt	Ska as pH, as osmolaritet te identifikuar ne katalog

Nga tabela e mësipërme duket qartë se për 10 nga 16 kategoritë e materialeve të kërkuara nga AK, materialet e ofruara nga prodhuesit për të cilët OE Omega Optikal është regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, ose nuk plotësojnë specifikimet teknike, ose nuk janë të pajisur me certifikim CE, ose të dyja bashkë. Pra, është tërësisht e papranueshme, e kundraligjshme, në dëm të interesit publik dhe shëndetit të qytetarëve si dhe diskriminuese për ne konkurentët e tjerë që sjellim përvojën dhe cilësinë maksimale, që të kualifikohet ky operator dhe të pranohet furnizimi me materiale që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga vetë AK.

Përgjigja e AK

“Argumentimi ku e mbështet pretendimin e vet OE ankimes janë konsultimi me kataloget e prodhuesve HEILPHARMA, FREDOOM, OPHTHALMIC dhe EYECON subjekt impartues i te

cileve eshte OE "OMEGA OPTIKAL". Argumenti mbeshtetet mbi supozime dhe indicie nga kataloget e firmave prodhuese, nderkohe qe ky argument nuk perputhet me dokumentacionin e pasqyruar ne SPP nga OE "OMEGA OPTIKAL" Pretendimet e Operatorit Ekonomike Pegasus LTD" Shpk, nuk kane asnjë lloj dokumentacioni tekniko ligjor apo prove të shkruar që të vërtetojë pretendimet e ankimuesit apo të ndihmojë AK' në thellimin e hetimit administrativ për të dhënë një përgjigje bazuar në lex specialis dhe parimin stricti iuris. Në këtë kuptim, referuar dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 12 ku citohet se: "Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj", neni 14 (Parimi i Objektivitetit) ku citohet se: Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative", neni 47 (E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime) ku citohet se: "Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes", neni 78 (Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ), pika 1 ku citohet se: "Pala bashkëpunon me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Ligji mund të parashikojë shprehimisht detyrimin e mëtejshëm të palës për të paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara organit publik", si dhe neni 82 (Barra e provës), pika 1 ku citohet se: "Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj", për çështjen në fjalë objekt shqyrtimi, lidhur me pretendimet e OE "PEGASUS LTD" shpk., ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës (kur barra e provës i bie kërkuarit) dhe OE ankimues në asnjë rast nuk ka sqaruar, argumentuar dhe më pas provuar me dokumente shtesë (por vetëm referuar dhe mbi bazën e pretendimeve) faktin e mosdorëzimit të dokumentacionit sipas formave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, apo faktin nëse pajisjet e cituara në ankesë nuk janë sipas formave të kërkuara etj. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron."

Në lidhje me përgjigjen e mësipërme të AK, sqarojmë se:

Përgjigja e mësipërme e KSHA, është prova më flagrante se si një AK vihet totalisht në funksion të një OE të caktuar: (i) duke injoruar tërësisht interesin publik dhe shëndetin e qytetarëve me tolerimin e furnizimit me mallra tërësisht jashtë standarteve dhe specifikimeve të kërkuara nga vetë AK; (ii) duke shkelur cdo parim të ligjshmërisë në procedurat administrative; dhe (iii) duke favorizuar haptazi këtë OE, në kurriz të shkeljes së barazisë dhe diskriminimit të OE të tjerë. Së pari, ndryshe nga sa pretendon KSHA, ne e kemi ezauruar detyrimin tonë të paraqitjes së provave që mbështesin pretendimet tona, pasi kemi referuar qartë në ankesën tonë me link konkret faqet e internetit ku gjendet informacioni në të cilin ne bazohemi; Së dyti, në madje e kemi tejkalluar këtë detyrim në kushtet kur nga vetë AK na janë krijuar pengesa për të marrë informacion të saktë, pasi edhe pse ne kemi kërkuar informacion bazuar në nenet 12 dhe 21 të LPP, që më datë 24.07.2018 deri në momentin e paraqitjes së kësaj ankese nuk kemi marrë ende një përgjigje nga AK dhe kjo është shkelje flagrante e ligjit. Së treti, KSHA është kontradiktore me vetveten, pasi në shqyrtimin e këtij pretendimi, nuk denjon as të verifikojë dhe të bëjë krahasimin e pretendimeve tona me dokumentat që ajo vetë administron dhe ka akses në SPE, ndërsa për shqyrtimin e pretendimit tonë nr.2, ka marrë përsipër të tejkalojë kompetencat e veta dhe të hyjë në regjistrat e QKB e të shqyrtojë të dhëna që ndodhen atje.

Së katërti, KSHA liston në mënyrë selektive një mori dispozitash të Kodit të Procedurave Administrative për të treguar se pretendimi jonë nuk shqyrtohet, pasi ne sipas KSHA "nuk kemi paraqitur prova për faktet e pretenduara prej nesh".

Por, kjo është thjesht një piruetë qesharake dhe e dëshpëruar, e veshur me citime ligjore dhe terma latinë të pavend dhe që s'kanë asnjë lidhje me situatën konkrete, madje dhe me citime të gabuara të neneve (shiko citimin e nenit 12 të KPA). Në këtë kontekst, po paraqesim edhe ne në vijim ato dispozita të Kodit të Procedurave Administrative që realisht aplikohen në situatën konkrete, të cilat KSHA ka ometuar ti citojë në përgjigjen e vet:

Dispozitë e shkelur nga AK

Neni 6 Parimi i informimit: 1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit. 2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

Dispozitë e shkelur nga AK (shiko pretendimin tonë nr.6 më poshtë)

Neni 16 Parimi i marrjes së vendimeve: Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, një organ publik merr vendime për të gjitha çështjet e ngritura nga një palë, të cilat janë në kompetencë të tij.

Dispozitë e shkelur nga AK

Neni 45 E drejta e palëve për njohje me dosjen: 1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre. 2. Organi publik, i përfshirë në procedurën administrative, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, siguron në mjediset e tij të punës kushte për mbajtjen e të dhënave, si dhe kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve, sipas pikës 1 të këtij neni. Në raste të veçanta, kur është më e përshtatshme për kërkuuesin, njohja me dosjen mund të bëhet edhe në mjediset e një organi tjetër publik ose në përfaqësitë konsullore dhe diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit. 3. Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose të përdoren nga të tretët vetëm me pëlqimin e individit, të cilit i përkasin këto të dhëna. Pëlqimi nuk kërkohet nëse dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore. 4. Kur dokumentacioni administrohet në formë elektronike, organi publik i siguron palës mjetet e nevojshme teknike për njohjen me të. Organi publik mund t'i bëjë dokumentet elektronike të aksesueshme nga interneti, nëse kjo nuk cenon Sigurinë e të dhënave të mbrojtura sipas ligjit. 5. Lëshimi i kopjeve të dokumenteve bëhet kundrejt një pagese, që përcaktohet në vendimin e organit publik dhe në çdo rast nuk kalon koston e riprodhimit të tyre.

Dispozitë e shkelur nga AK

Neni 77 Parimi i hetimit kryesisht: 1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes. 3. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm elementet e nevojshme për identifikimin e tyre.

Dispozita të injoruara nga AK

Neni 82:3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.

4. Palët mund t'i kërkojnë organit publik që të marrë masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij gjatë procedurës administrative.

Dispozitë e injoruar nga AK

Neni 84: Metodat për paraqitjen e informacionit dhe provave Në rastet kur palët janë të detyruara të paraqesin informacion ose prova, pala duhet të njoftohet me shkrim apo në mënyrë verbale, sipas afateve dhe parashikimeve të këtij Kodi.

Dispozitë e injoruar nga AK

Neni 90 Përfundimi i procedurës administrative: 1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.

Pavarësisht nga dispozitat e sipërcituara, në konstatojmë se edhe pse ne e kemi përmbushur detyrimin tonë për të provuar pretendimin tonë dukë referuar drejtpërdrejtë në link të katalogëve të prodhuesve, për lehtësi shqyrtimi, në këtë fazë të ankimit, ia bashkëlidhim të printuara ankesës si Aneks 9, edhe pse provat e vërteta janë ato që pikërisht AK disponon dhe që në kundërshtim me ligjin nuk na i ka vënë në dispozicion, dokumentat e ngarkuara nga OE Omega Optikal në SPE. Në përfundim, rezulton qartë se e vetmja gje që KSHA ka synuar të bëjë me përgjigjen për këtë pretendim është të shmanget nga shqyrtimi dhe vlerësimi i faktit të pakontestueshëm se mallrat dhe dokumentacioni përkatës respektivisht i ofruar dhe i depozituar në SPE nga OE Omega Optikal nuk pënbushin specifikimet tekike dhe kërkesat e cilësisë të vendosura nga AK.

II.7. Në datën 23.08.2018, nëpërmjet shkresës me nr.2769/9 prot., datë 23.08.2018, me objekt: “Dërgim informacioni për Vendimin nr. 1399/I prot., datë 17.08.2018, protokolluar pranë QSUT me nr. 27691/7, datë 20.08.2018”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pegasus” sh.p.k. & “Gen – Albfarma” sh.p.k.

Public Health Sector

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pegasus” sh.p.k. & “Gen – Albfarma” sh.p.k, mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Omega Optikal” sh.p.k. se: “OE Omega Optikal nuk ka plotësuar kërkesat e pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit ku kërkohet që për qëllime kualifikimi OE duhet të paraqesin: “Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve te fundit (2015, 2016, 2017), të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet. Mbështetur në VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar", bilanci duhet të depozitohet në organet tatimore jo më vonë se data 31 Mars e vitit pasardhës, ndërsa bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për

Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, neni 43, pika (a), bilancet duhen depozituar në QKB jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.

Duke iu referuar ekstraktit historik të shoqërisë Omega Optikal të datës 24.07.2018 (Aneksi 4), rezulton se Bilancet e vitit 2015 dhe 2016 të kësaj shoqërie janë të pakonfirmuara nga tatimet, ndërsa Bilanci i vitit 2017 nuk është fare i depozituar në QKB. Në këto rrethana, për shkak të mosdepozitimit të bilanceve sipas kërkesës së pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit, KVO duhej ta kishte skualifikuar këtë operator dhe të mos pranonte ofertën e tij[...], Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, gërma “a”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *“Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve te fundit (2015, 2016, 2017), të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet”.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton që në përmbushje të këtij kriteri, ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument bilanc të vitit 2015, 2016, 2017.

Rezulton se është paraqitur ekstrakti i thjeshtë dhe ekstrakti historik i shoqërisë, në të cilin evidentohet se është depozituar pranë QKB bilanci i vitit 2015 dhe bilanci i vitit 2016.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.*

III.1.4. Në nenin 27, pika 5, gërma “a” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse”.*

III.1.5. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon se: *“[...] Qëndrimi i mësipërm i KSHA është absurd, tërësisht i kundraligjshëm dhe një avokati haptazi jo vetëm për KVO, por edhe për të justifikuar dhe mbuluar dështimin e OE Omega Optikal për përmbushjen e kërkesave të pikës 2.2 (a) të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit!!! Në mënyrë të qartë ne kemi ngritur pretendimin se referuar ekstraktit historik të shoqërisë Omega Optikal të datës 24.07.2018, rezulton se Bilancet e vitit 2015 dhe 2016 të kësaj shoqërie janë të pakonfirmuara nga tatimet, ndërsa Bilanci i vitit 2017 nuk është fare i depozituar në QKB. Nga përgjigjia e KSHA, kuptojmë se jo vetëm pretendimi jonë është i saktë, por këto bilance nuk janë dorëzuar fare nga ky OE në SPE, dhe KSHA tenton ta justifikojë kualifikimin e këtij OE, pavarësisht nga kjo mangësi thelbësore, pra pavarësisht nga mungesa fizike e dokumentacionin kualifikues në SPE, duke bërë sofizma në lidhje me nevojën ose jo të aplikimit të detyrueshëm të kësaj kërkesë. Sqarojmë se arsyetimi i KSHA mund të ketë vlerë nëse jemi në fazën e kundërshtimit të Dokumentave të Tenderit, por për sa kohë Dokumentat e Tenderit, përfshirë kërkesat për kualifikim, janë të miratuara, të shpallura dhe jemi në fazën e vlerësimit të ofertave, KVO dhe KSHA kanë detyrimin e thjeshtë të verifikojnë në mënyrë kumulative vetëm sa vijon: A janë paraqitur të gjitha dokumentat e kërkuara në Dokumentat e Tenderit për qëllime kualifikimi?”*

A plotësojnë të gjitha dokumentat e paraqitura kërkesat për kualifikim? Sa më sipër është e qartë edhe nga vetë Dokumentat e Tenderit ku në faqen 28, përcaktohet qartë se: "Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim " Edhe justifikimi i KSHA duke thirrur në ndihmë VKM nr. 495, datë 13.09.2017 "Për Miratimin e Rregullave të Përfitimit të Shërbimeve Publike Elektronike" është krejtësisht i pavend, aq më tepër kur KSHA duke tejkuluar kompetencat dhe detyrat e veta shprehet se: "KSHA verifikoi dhe konstatoi se Operatori Ekonomik "OMEGA OPTIKAL" sh.p.k ka te miratuara dhe publikuar pranë QKB pasqyrat financiare (bilancet) 2015, 2016, 2017. ". Vendimin për skualifikimin apo kualifikimin e një OE e merr KVO dhe jo KSHA, detyra e së cilës është të thjesht të verifikojë pretendimet e ankimuesit dhe jo të argumentojë vendimin e KVO me fakte të ngjara pas vendimmarrjes së KVO. Nga verifikimi i bërë në QKB, rezulton se këto bilance janë publikuar më datë 26.07.2018, pra 3 ditë pasi KVO kishte mbyllur vendimmarrjen e vet për kualifikimin (të kundraligjshëm duhet të shtojmë) të OE Omega Optikale. Faktet e ngjara pas kësaj date nuk mund të përdoren nga KSHA për të justifikuar vendimmarrjen e KVO, e cila sidoqoftë duhet të bazohet vetëm në dokumentacionin e paraqitur nga OE në SPE si pjesë e ofertës. Edhe mënyra e trajtimit të këtij pretendimi tonë, tregon për njëanshmëri dhe favorizim hapazi nga KVO dhe KSHA të këtij operatori dhe njëkohësisht shkelje të barazisë dhe diskriminim të operatorëve të tjerë konkures, të cilët kanë treguar kujdesin maksimal për dorëzimin e plotë dhe të saktë të ofertës së tyre".

III.1.6. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, si edhe në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, argumenton se: "[...] Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik "OMEGA OPTIKAL" në SPP rezulton se xhiro në vlerë mesatare për periudhën e kërkuar në dokumentat e procedurave tejkulon vlerën e tenderit Si dhe referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik ku vendosja e kritereve ka si synim kryesor që ti shërbejë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, ekonomike e financiare, organizative, në makineri dhe pajisje si dhe asete të tjera fizike apo personelin e nevojshme, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E shprehur ndër të tjera në nenin 46, (Kualifikimi i Ofertuesve), germa c) gjendja ekonomike e financiare, ku citohet se: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur; të LPP, si dhe VKM nr. 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, neni 27 (Kontratat e mallrave) pika 5, ku ndër të tjera citohet se: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose b) "kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose"

c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (e plotësuar nga

OE në SPP). Dhe në interpretim të nenit 46 të LPP si më sipër, apo nenit 27 të RPP, frymës së legjislacionit të prokurimit, KSHA gjykon se KVO ka vlerësuar drejt duke krijuar bindjen se OE “Omega Optikal” sh.p.k., gëzon potencial ekonomik e financiar për të pëmbushur këtë kontratë. Gjithashtu bazuar në vendimin nr. 495, datë 13.09.2017 “Për Miratimin e Rregullave të Përfitimit të Shërbimeve Publike Elektronike”, në seksioni 11, “Përmbajtja dhe Vlefshmëria e Dokumenteve Administrative Elektronike” ku thuhet se : “5. Dokumentet administrative elektronike të përfitohen nga transmetimi elektronik i të dhënave me Vulë elektronike kanë të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si do dokument tjetër zyrtar. 6. Dërgimi dhe pranimi i të dhënave kryhen në përruthje të plotë me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara. 7. Dokumentet administrative elektronike duhet të përmbajnë të paktën: a) të dhënat e kërkuara prej aplikuesit të cilat përfitohen nëpërmjet shërbimit të transmetimit elektronik nga sistemi që disponon bazën e të dhënave b) vulën elektronike të institucionit lëshues të dokumentit c) shënimin në fund të faqes: “Ky dokument është lëshuar nga sistemi elektronik bazuar në bazën e të dhënave shtetërore të institucionit lëshues”. 8. Vulosja e dokumenteve administrative elektronike të gjeneruara nga transmetimi elektronik garanton autenticitetin e dokumentit në formatin elektronik.”, si dhe në njoftimin e Agjencise së Prokurimit Publik me nr. 14307 prot. dt. 23.11.2017 “Mbi barazvlefshmërinë e dokumenteve administrative elektronike me dokumentet zyrtare”, KSHA verifikoi dhe konstatoi se Oeratori Ekonomik “OMEGA OPTIKAL”sh.p.k. ka te miratuara dhe publikuar prane QKB pasqyrat financiare (bilancet) 2015, 2016, 2017. Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.7. Për sa mësipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik “Omega Optikal” sh.p.k, nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike bilanc të asnjërit prej viteve të kërkuara 2015, 2016, 2017, duke mos e pëmbushur kështu kriterin e sipërcituar. Operatori ekonomik “Omega Optikal” sh.p.k. duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Fakti i mosdorëzimit të bilanceve të viteve 2015, 2016, 2017, sipas kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pranohet edhe nga vetë autoriteti kontraktor, i cili në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, si edhe në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë KPP-së, i referohet vetëm dokumentacionit të depozituar pranë QKB-së nga ky operator ekonomik, duke sqaruar (citojmë): “KSHA verifikoi dhe konstatoi se Oeratori Ekonomik “OMEGA OPTIKAL”sh.p.k. ka te miratuara dhe publikuar prane QKB pasqyrat financiare (bilancet) 2015, 2016, 2017”, pra autoriteti kontraktor nuk sqaron faktin e paraqitjes së bilanceve në sistemin e prokurimeve elektronike, por ka verifikuar se bilancet janë të miratuara dhe të publikuara pranë QKB për vitet 2015, 2016, 2017.

III.1.8. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive fizike që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.9. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pegasus” sh.p.k. & “Gen-Albfarma” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se oferta e operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k. është anomalisht e ulët dhe nuk ka dhënë justifikimin e duhur për këtë ofertë sipas legjislacionit në fuqi me argumentimin: “KVO e AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 56 (1) dhe 57 (1) të Ligjit Për Prokurimin Puka dhe nenit 66 (3), (5) të VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, me mënyrën se si ka vepruar me verifikimin e ofertës së OE Omega Optikal si ofertë anomalisht e ulët. Nga konsultimi i SPE vërejmë se në datë 23.07.2018, pra në të njëjtën ditë kur është njoftuar kualifikimi dhe renditja e ofertave, është hedhur në sistem kërkesa e KVO të AK për sqarime nga OE Omega Optikal për ofertë të konsideruar anomalisht të ulët dhe në të njëjtën ditë ky OE kthen përgjigje në sistem, përgjigje e cila është vetëm kaq: “Pershendetje. Cmimet e ofruara janë me konkuruese! dhe te ulta ngaqë si operator i ri duam te jemi pjese e tregut, dhe kjo dhe me mbeshtetjen e kompanive furnizuese.

Omega optikal punon kryesisht me operatore privat, dhe per te kete kete tender e shikon si mundesi per hyrjen dhe ne tregun e spitaleve. Omega optika mer persiper ofrimin e materialeve te kerkuare nga ju sipas specifikimeve perkatese me cmimet e oferte se paraqitur nga ana jone, shpresoj ne mirekuptimin tuaj. " Duket se kjo pergjigje ka qene e mjaftueshme per KVO e AK per te kualifikuar ketë OE dhe per te pranuar ofertën e tij me gjithë vlerën anomalisht të ulët dhe parregullsitë dhe mosplotësimet e listuara më sipër. Mënyra e mësipërme e trajtimit të sqarimeve për ofertën anomalisht të ulët është tërësisht në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara. Së pari, sipas nenit 56 (1) të LPP, kërkesa e AK për operatorin me ofertë anomalisht të ulët duhet bërë në mënyrë shkresore dhe jo duke u hedhur në sistem, pasi kështu është shkelur neni 57 (1) i LPP. Së dyti, sic përcakton neni 56 (1) i LPP, AK duhet ti kërkonte këtij operatori në mënyrë të detajuar shpjegime për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e mallrave; c) origjinalitetin e mallrave të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të sigurohet furnizimi. Në fakt AK nuk e ka bërë kërkesën në këtë mënyrë sic kërkohet nga ligji. Së treti, sipas nenit 66 (5) të VKM "Për rregullat e prokurimit publik", ofertuesi të cilit i kërkohen sqarimet për ofertën anomalisht të ulët, jo vetëm duhet të përgjigjet në formë shkresore (cka nuk rezulton të ketë ndodhur), por për më tepër "ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shbesore sqarime! për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LP Asnjë argumentim konkret nuk është bërë nga ky ofertues, dhe as nuk janë paraqitur prej tij prova shkresore që të sqarojnë elementët e veçanta të ofertës së tij sic kërkohet nga ligji. Ky ofertues është mjaftuar me një paragraf të përgjithshëm të hedhur në sistem që nuk sqaron asgjë dhe cka është më e papranueshme dhe tërësisht e kundraligjshme është që ky lloj "sqarimi" në mënyrë të papërgjegjshme është konsideruar i mjaftueshëm nga AK", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se autoriteti kontraktor ka mbajtur procesverbalin e konstatimit datë 18.07.2018, sipas të cilit oferta e operatorit ekonomik "Omega optikal" sh.p.k. ka rezultuar anomalisht e ulët në zbatim të nenit 56 të LPP-së, e në vijim të këtij neni, KVO –ja ka kërkuar sqarim nga operatori ekonomik "Omega optikal" sh.p.k. në sistemin e prokurimeve elektronike. Autoriteti kontraktor informon gjithashtu se (citojmë): "[...] më datë 23.07.2018 në SPE u administrua përgjigje nga operatori ekonomik ofertues, përgjigje e cila u mor në shqyrtim nga KVO. KVO pas konsultimeve, bazuar në nenin 56, pika 1/b dhe 2 e ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, VKM 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe nisur nga parimi i legjislatorit ku çmimet e ulëta mund të rezultojnë potencialisht në përfitime të konsiderueshme financiare për autoritetin kontraktor krijon bindjen se OE ofertues është i aftë të përmbushë kontratën duke u kualifikuar si operator ekonomik i suksesshëm".

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë KPP-së, konstatohet se nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, operatori ekonomik "Omega optikal" sh.p.k. ka kthyer përgjigje si më poshtë vijon: "Çmimet e ofruara janë më konkurrueset dhe të ulëta ngaqë ne si operator i ri duam të jemi pjesë e tregut, dhe kjo dhe me mbështetjen e kompanive furnizuese. Omega optikal punon kryesisht me operatorë privatë dhe për të këtë tender e shikon si mundësi për hyrjen dhe në tregun e spitaleve. Omega optikal merr përsipër ofrimin e materialeve të kërkuara nga ju sipas specifikimeve përkatëse me çmimet e ofertës së paraqitur nga ana jonë".

III.2.3. Konstatohet se autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues nuk e ka shqyrtuar fare këtë pretendim të operatorit ekonomik.

III.2.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:*

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.2.5. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: *“Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP [...]”.*

III.2.6. Në dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi, Kreu II, Seksioni 3, pika 3.3. “3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 *Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .*

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përlllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.2.7. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, KPP gjykon se, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP, thekson se, në nenin 1, gërma “b”, “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k. konstaton se, nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, referuar bazës ligjore si më sipër cituar, kjo ofertë është anomalisht e ulët dhe sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se, edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqitej analiza e çmimeve të ofruara, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton se, nga ana e operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k, me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar një përgjigje e thjeshtë

në sistemin e prokurimeve elektronike (jo me shkrim sipas legjislacionit si më sipër cituar), pa bërë asnjë dokumentim apo justifikim të ofertës së tij, por thjesht duke cituar se është një firmë e re që do të hyjë në tregun e spitaleve.

III.2.9. Nga verifikimi i bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik, rezulton se, ky operator ekonomik ka paraqitur thjeshtë një përgjigje duke cituar se “kemi ofruar çmime të ulëta pasi duam të jemi pjesë e tregut”, por duke mos bërë asnjë argumentim (analizë) përkatëse mbi koston e cmimeve të ofruara për produktet objekt prokurimi si edhe nuk e ka shoqëruar me dokumentacion provues, për ta mbështetur këtë analizë. Me anë të kësaj përgjigje të operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k., qartësisht evidentohet se nuk është paraqitur asnjë analizë, argumentim dhe akoma më tej, në asnjë moment nuk është paraqitur asnjë argumentim se përse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet, pasi ky operator ekonomik, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, për më tepër nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës apo provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi apo kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë anomalisht e ulët nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, është paraqitur vetëm një përgjigje e cila në vetvete nuk është një argumentim/analizë, si edhe nuk është e mbështetur në fakte e prova që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

III.2.10. KPP gjykon se, operatori ekonomik “Omega optikal” sh.p.k, ka patur detyrimin që të dërgojë pranë autoritetit kontraktor analizën e çmimeve dhe ta shoqërojë me dokumenta provues (fatura blerje, fletë zhdoganimi etj), pasi në këtë përgjigje nuk ka asnjë informacion, analizë etj., sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për ofertën anomalisht të ulët.

KPP riktheson se, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, i cili duhet të jap analiza sa më të sakta dhe të shoqëruara me dokumenta provuese për të bindur autoritetin kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k., oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk janë paraqitur as sqarime, as argumentime, të cilat rrjedhimisht edhe nuk janë të provuara me dokumentacionin përkatës, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj.

Rrjedhimisht, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k. nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pegasus” sh.p.k. & “Gen - Albfarma” sh.p.k., për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori ekonomik do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pegasus” sh.p.k. & “Gen - Albfarma” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur - Marrëveshje Kuadër”, me objekt Loti 1 “Materiale mjekësore për ndërhyrjen e Kataraktit”, me nr. REF-70198-05-21-2018, me fond limit për njësi 36.300 lekë (pa TVSH) dhe vlerë totale të pritshme të kontratës 37.640.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë tereza”, Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Omega optikal” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pegasus” sh.p.k. & “Gen - Albfarma” sh.p.k.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1399 Protokoll
Datë 15.08.2018



Public Health Sector KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar Enkeleda Bega	Anëtar Vilma Zhupaj	Anëtar Lindita Skeja	Anëtar Merita Zeqaj
---	--------------------------------------	---------------------------------------	--------------------------------------

Kryetar
Evis Shurdha